



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.280/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN-it dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur Levizja Vetevendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr.280/2017 e datës 12.06.2017, me të cilin është pretenduar se kandidati për deputet Kujtim Shala, nga Levizja Vetevendosje, ka vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore në Facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

### **A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës, BIRN-it dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 10.06.2017, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidati për deputet Kujtim Shala, nga Levizja Vetevendosje, ka vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore në Facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet si e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkrësat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar se shkelësi i supozuar e ka vazhduar sponzorimin e fushatës edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 10.06.2017. Nga prova e ofruar nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit

të supozuar është publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore sepse data dhe ora e paraqitur ne fotografi, në shiritin e statusit te pajisjes (fusha e notifikimeve) nuk e dëshmon fakti se e njëjta është publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore, ngase nga fotografia që është paraqitur reklama nuk ekziston data dhe ora e reklamimit-publikimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.280/2017 më datën 13.06.2017

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*

**Kyesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

